



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 24 maj 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Bajram Kosumi, Ramadan Gashi, Adem Gani Geci, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selville Halimi, Kolë Berisha dhe Mufera Şinik

Mungoi: Radmila Vujović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Luljeta Shehu – deputete, Hilmi Jashari – IAP (ekspert i angazhuar nga Komisioni), Besnik Ramadanaj – KDI, Lumnije Murati – ZPRK, Lejla Selimi – OSBE, Jeton Bytyçi – OSBE, Arlinda Carioi, Jet – Kosova, Blerta Bejtullahu – ICO dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 12 dhe të 17 majit 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit dhe i amendamenteve, të propozuara nga grupi i punës për këtë ligj,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore, të propozuara nga komisioni funksional.
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 12 dhe të 17 majit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të 12 dhe të 17 majit 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit dhe i amendamenteve, të propozuara nga grupi i punës për këtë ligj

Kryetari – I falënderoi anëtarët e Komisionit që kishin punuar në grupin e punës për shqyrtimin e Projektligjit për Avokatin e Popullit. I paraqiti për shqyrtim propozimamendamentet e grupit të punës, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore dhe amendamentet e deputetit Riza Smaka. Fjalën ia dha deputetit Bajram Kosumi që ta paraqiste arsyetimin për amendamentet.

Bajram Kosumi - kryesues i grupit - E njoftoi Komisionin për punën në shqyrtimin e Projektligjit, i cili ishte shqyrtuar nen për nen, me përkrahjen e ekspertit të angazhuar nga Komisioni. Amendamentet e propozuara i konsideroi se e plotësonin përmbajtjen e ligjit. Tha se çështje të hapura i kemi lënë tri nene: 5, 11 dhe 23, që të diskutohen në Komision. Sqaroi në emër të grupit për qëndrimet që i kishin pasur për këto nene. Kishin vërejtur se Projektligjit i mungonin përkufizimet dhe kishin kërkuar nga eksperti t'u ofronte zgjidhje që të vendosnin në Komision se a do të përkraheshin.

Ishte i diskutueshëm nenin 5 i Projektligjit për zëvendësit e Avokatit të Popullit, se a duhet të jenë 3 apo 5.

Ibrahim Makolli – Në fillim ishte qëndrim i Komisionit se 5 zëvendës ishin të mjaftueshëm dhe bëri krahasime si është rregulluar kjo çështje në vendet e tjera. Në konsultim edhe me përfaqësuesit e zyrës së Avokatit dhe për shkak të nevojave të këtij institucioni, të ndarë në departamente për fushat e caktuara, ishte konstatuar se 3 zëvendës nuk mjaftonin. Dha sqarime për nevojat e fushëveprimit të këtyre departamenteve. Për paragrafin 1.4 shtoi se duhet të jetë “*personeli administrativ*”. U pajtua që numri i zëvendësve të mbetet siç është paraparë në Projektligj.

Adem Hajdaraj - Ndau mendimin se mjaftojnë që Avokati i popullit t'i ketë 3 zëvendës, e jo 5, si në Projektligj. Meqë duhet të përfshihet ndonjë edhe nga radhët e minoriteteve, mjafton që një zëvendës të jetë nga radhët e tyre. Ishte i mendimit se duhet të jenë 3 zëvendës, sepse edhe në grupin e punës është diskutuar që të jenë 3.

Luljeta Shehu – Duke i pasur parasysh përfaqësimin e minoriteteve dhe përfaqësimin gjinor, u pajtua me Ibrahim Makollin që të jenë 5 zëvendës.

Selviqe Halimi - Dha sqarime për nenin 5, paragrafi 1.4 “Personeli profesional - Ligji për pagat” parasheh zyrtarë të lartë profesionalë, ndërsa në Projektligjin për Avokatin e Popullit janë përkufizuar si

personel profesional, që mund t'i ketë disa kuptime. Edhe nëse mbetet kështu, nuk paraqet ndonjë problem, sepse Ligji për pagat do t'i përfshijë në pozicionet përkatëse.

Gani Geci – Për nenin 5, paragrafi 1.4, ishte i mendimit se duhet të qartësohet çka është “*personel profesional*” dhe çka përfshihet te kjo kategori.

Adem Hajdaraj - Duke folur për nenin 8, paragrafi 11, tha se duhet t'i lihet në kompetencë Avokatit të Popullit t'i propozojë zëvendësit, sepse do të punojë me ta.

Armend Zemaj - Propozoi që në nenin 8, paragrafi 11, të shtohen fjalët: “*sipas konkursit të shpallur nga Kuvendi Kosovës*”.

Ibrahim Makolli - Propozoi që neni 8, paragrafi 11, të riformulohet: “*Propozimin e zëvendësve e bën Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente, sipas konkursit të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës*”.

Ishin të diskutueshëm: neni 8, paragrafi 11, neni 15,34 dhe 35, për të cilët diskutuan: Bajram Kosumi, Ibrahim Makolli, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Adem Hajdaraj, Gani Geci dhe Selvije Halimi.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

I. Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi i punës i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe procedohen për shqyrtim të mëtejme.

Amendamenti 1

Neni 1

Në rreshtin e dytë fjala “**mekanizmave**” korrigjohet dhe bëhet “**mekanizmit**”, ndërsa në rreshtin e fundit shtohet fjalia: “, **të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre**”.

Amendamenti 2

Neni 2

Në rreshtin e shtatë hiqet fjala “**paraqitjen**” dhe zëvendësohet me “**parashtrimin**” dhe teksti vazhdon si në ligj.

Amendamenti 3

Neni 3

Në nenin 3, paragrafi 2, në rreshtin e gjashtë, pas fjalës **publike**, shtohen fjalët: **“të Republikës së Kosovës”** dhe teksti tjetër hiqet.

Amendamenti 4

Neni 5, paragrafi 1, pika 4, fjalët: **“personeli mbështetës”**, zëvendësohen me **“administrata”**.

Amendamenti 5

Neni 6, paragrafi 1, pika 6, në rreshtin e parë hiqen fjalët: **“jetë anëtar i asnjë”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“ushtrojë funksion në”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Amendamenti 6

Neni 7, paragrafi 2, pika 1, në rreshtin e tretë, pas fjalës **paragrafin**, shtohet: **“1 dhe”**, ndërsa pas fjalës **përveç**, shtohet fjalia: **“mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë”** dhe teksti tjetër hiqet.

Amendamenti 7

Neni 8

Neni 8, paragrafi 2, në rreshtin e parë, hiqen fjalët: **“propozimit, si dhe”** dhe teksti vazhdon si në ligj. Në paragrafin 3 dhe në tërë tekstin e Projektligjit hiqet fjala **“Ad hoc”** dhe zëvendësohet me **“përkatës”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 4, riformulohet si vijon: **“Kuvendi i Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e Avokatit të Popullit në medie të shkruara dhe elektronike”**.

Në paragrafin 5, në rreshtin e parë, hiqet fjala **“thirrje/ftesë”** dhe zëvendësohet me fjalën **“konkurs”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Në paragrafin 6, në rreshtin e katërt, hiqet fjala **“e propozuar”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 11, riformulohet si vijon: **“Propozimin e zëvendësve e bën Avokati i Popullit në bazë të konkurrencës së hapur dhe transparente, sipas konkursit të shpallur nga Kuvendi i Kosovës.**

Paragrafi 12. riformulohet si vijon: **“Propozimi i Avokatit të Popullit e përmban arsyetimin për kandidatët e propozuar”**.

Paragrafi 14 hiqet

Amendamenti 8

Neni 9

Neni 9, paragrafi 2, ndahet në dy paragrafë.

Paragrafi 2 (**Avokati i Popullit duhet të zgjidhet brenda 30 ditëve nga dita e propozimit të kandidatëve. Nëse ky afat nuk është arritur, Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, në secilën seancë plenare për 30 ditë të tjera**).

Paragrafi 2, në rreshtin e parë, hiqet fjala **“duhet të”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 3, (**Nëse Avokati i popullit nuk emërohet pas 60 ditëve, komisioni i Kuvendit përsëri do të shpallë konkurs për Avokat të Popullit**).

Paragrafi 3, në rreshtin e parë, hiqen fjalët **“emërohet pas”** dhe zëvendësohen me **“zgjidhet brenda”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 3 i Projektligjit ndahet në dy paragrafë dhe bëhen paragrafët 4 dhe 5

Paragrafi 4 i Projektligjit bëhet paragrafi 6 dhe riformulohet si vijon: **“Nëse Kuvendi nuk i zgjedh zëvendësit në afat prej 60 ditëve, Kuvendi shpall konkurs të ri”** dhe radhitja vazhdon si në ligj.

Amendamenti 9

Neni 10

Neni 10, paragrafi 1, në rreshtin e parë hiqen fjalët **“dhe zëvendësit e tij,”** ndërsa në rreshtin e dytë fjala **“marrin”** zëvendësohet me fjalën **“merr”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e tretë, pas fjalës: **besnikëri**, shtohen fjalët: **“në mënyrë të pavarur dhe të paanshme”** dhe teksti vazhdon si në ligj, deri te fjala **Kosovës** dhe pjesa tjetër e tekstit hiqet.

Amendamenti 10

Neni 12

Neni 12, paragrafi 2, në rreshtin e pestë, hiqen fjalët: **“ose suspendimin e përkohshëm”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e dytë, hiqen fjalët **“ose përkohësisht të suspendojë”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Amendamenti 11

Neni 13

Në titullin e nenit 13, fjala **“Mbarimi”** hiqet dhe zëvendësohet me **“Përfundimi”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 1, pika 3 riformulohet si vijon: **“Kur mbaron afati 5 (pesë) -vjeçar për Avokatin e Popullit ndërsa 3 (tre) -vjeçar për zëvendës të Avokatit të Popullit”.**
Amendamenti 12

Neni 14

Në titullin e nenit 14, fjala: **“Mbarimit”**, hiqet dhe zëvendësohet me **“Përfundimit”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafët 2 dhe 4 hiqen.

Amendamenti 13

Neni 16, në paragrafin 1, pika 2, hiqen fjalët: **“në cilëndo pjesë të territorit të Republikës së Kosovës”**, ndërsa në rreshtin e pestë hiqet fjala **“propozimin”** dhe zëvendësohet me **“rekomandim”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 1, pika 3, në rreshtin e tretë, hiqen fjalët: **“veçanërisht racor dhe etnik”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 1, pika 6, në rreshtin e parë dhe në rreshtin e tretë fjala: **“miratimin”** hiqet dhe zëvendësohet me **“nxjerrjen”**, ndërsa në rreshtin e katërt hiqet fjala: **“masave”** dhe zëvendësohet me fjalët: **“akteve nënligjore dhe”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Amendamenti 14

Neni 18, paragrafi 1, në rreshtin e tetë, hiqet fjala **“zbatuar”** dhe zëvendësohet me **“ushtruar”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Paragrafi 2, riformulohet si në vijim: **“çdo ankesë për fillimin e procedurës, si rregull, paraqitet me shkrim. Kërkesa për fillimin e procedurës mund të paraqitet edhe gojarisht, në rast se nuk mund të bëhet me shkrim.”**

Paragrafi 3 hiqet.

Amendamenti 15

Neni 20, paragrafi 1, pika 5, hiqet.

Amendamenti 16

Neni 23, paragrafi 2, në rreshtin e fundit, shtohen fjalët: **“, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.**

Amendamenti 17

Neni 24, në rreshtin e katërt, pas fjalës **thirrur** shtohen fjalët: **“e që punon në institucionet publike”** dhe teksti vazhdon si në ligj.

Amendamenti 18

Neni 25, në rreshtin e fundit, shtohet fjalia: **“Vendimi i tij u dërgohet parashtruesit të ankesës dhe autoriteteve publike përgjegjëse”.**

Amendamenti 19

Nenit 27 i ndërrohet titulli në :**“Publikime të raporteve të veçanta“** dhe bëhet neni 28, kurse neni 28 bëhet neni 27 dhe riformulohet paragrafi 2, si vijon:

“1. Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Kosovës raportin për vitin paraprak deri me 31 mars”.

“2. Avokati i popullit e paraqet raportin në seancë plenare, në të cilën diskutohet”, ndërsa paragrafi 3 hiqet.

Amendamenti 20

Neni 29, paragrafi 2, bartet te neni 11.

Amendamenti 21

Neni 33, **paragrafi 2**, hiqet.

II. Komisioni nuk i përkrahu amendamentet e propozuara të deputetit Riza Smaka në Projektligjin për Avokatin e Popullit.

III. Komisioni nuk i përkrahu amendamentet 1, 2, 4, 5 dhe 6, të propozuara nga Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore, ndërsa u përkrah amendamenti 3.

Amendamenti 3

Neni 8

Shtohet paragraf i ri: **“Procedura e zgjedhjes së Avokatit të Popullit dhe e zëvendësve të Avokatit të Popullit, rregullohet me rregullore të posaçme të Kuvendit të Kosoves.”**

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve ne Projektligjin për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore, të propozuara nga komisioni funksional

***Kryetari** – I paraqiti propozimamendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore, të propozuara nga komisioni funksional, që të konstatohet baza juridike.*

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni i shqyrtoi propozimamendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Komisioni vlerëson se amendamentet e propozuara kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

5. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni